

Pas tragjedisë që ndodhi në Turqi ku dhjetëra minatorë humbën jetën pas eksplodimit dhe zjarrit që ka shpërthyer në një minierë thëngjilli në perëndim të Turqisë, Erdogan ka anuluar vizitën e paralajmëruar për nesër në Tiranë.

Kryeministri Edi Rama e ka bërë të ditur shtyrjen e vizitës së kryeministrit turk, pas një bisede që ka pasur me të nëpërmjet telefonit.

“Bisede e trishte me km Erdogan për tragjedinë e minatoreve në Turqi dhe mirëkuptim për shtyrjen e vizitës në TR! Me zëmër pranë në dhimbje”, shkruan Rama në Facebook.